



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

Për Aktivitetin e Prokurimit: 328-26-1598-2-2-1

Sa i përket tenderit për: Servisim dhe mirëmbajtja e sistemi të shuarjes automatike të zjarrit (aerosol) dhe aparate kundër zjarrit në gjykatat e Kosovës dhe në SKGJK

ANKESË

1. IDENTIFIKIMI I ANKUESIT*

ALBKOS SAFETY SH.P.K.

(shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. e Pejës, nr. 26

(Adresa)

Fushë Kosovë

(Vendi)

044 504 605

(Numri i telefonit)

Emin Mirena

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

12000

(Kodi Postar)

038 534 653

(Numri i faksit)

info@albkossafety.com

(adresa elektronike)

07.05.2026

(data e parashtrimit të ankesës)

(nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.



2. TË DHËNAT MBI AKTIVITETIN E PROKURIMIT

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- | | |
|----|------------------------------------------------------|
| 01 | Njoftimi për kontratë, 02.04.2026 |
| 02 | Kërkesë për informata shtesë 16.04.2026 |
| 03 | Korrigjimi i dosjes së tenderit 17.04.2026 |
| 04 | Sqarimi i dosjes së tenderit, më 20.04.2026 |
| 05 | Kërkesë për rishqyrtim, më 28.04.2026 |
| 06 | Vendimi i AK mbi kërkesën për rishqyrtim, 29.04.2026 |

3. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

JO

Procedura është në proces dhe hapja ende s'ka ndodhur ende. Afati i dorëzimit – aktiviteti aktualisht është pezulluar.

4. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit?

Po

JO

Aktiviteti i prokurimit është në proces, afati për dorëzimin e tenderit aktualisht është pezulluar.

5. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

JO

- | |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <ul style="list-style-type: none">▪ Kërkesa për Informata Shtesë, më 16.04.2026.▪ Sqarimi i DT nga AK, më 20.04.2026▪ Kërkesa për Rishqyrtim: më 28.04.2026.▪ Vendimi i AK mbi kërkesën për rishqyrtimin: 29.04.2026 |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të

Neni 1 – Qëllimi
Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 28 – Specifikimet teknike
Neni 53 – Sigurimi i informatave shtese per kandidatët dhe tenderuesit
Neni 108A - i Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092
Rregullorja Nr. 001/2022: Nenet 17.33, 17.34, 17.35, 45.13, 62.2

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Në përputhje me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, paraqesim ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim, në kuadër të aktivitetit të prokurimit me titull **“Servisimi dhe mirëmbajtja e sistemit të shuarjes automatike të zjarrit (aerosol) dhe aparateve kundër zjarrit në gjykatat e Kosovës dhe në SKGJK”**, me numër të prokurimit **328-26-1598-2-2-1**.

SQARIM HYRËS

Me qëllim që çështja të kuptohet edhe nga persona që nuk janë të specializuar në fushën e mbrojtjes nga zjarri, në vijim po japim një kontekst të më të gjerë teknik dhe procedural, të këtij aktiviteti të prokurimit.

Aktiviteti i prokurimit i lartcekur është publikuar më **02.04.2026**. Sipas njoftimit për kontratë, aktiviteti zhvillohet si **kontratë publike kornizë**, për periudhë **24-mujore**, me vlerë të parashikuar prej **70.000,00 EUR**. Si kriter për dhënien e kontratës është përcaktuar **“çmimi më i ulët për njësi me poentim”**, sipas strukturës së përcaktuar në dokumentacionin e tenderit.

Ky aktivitet paraqet vazhdimësi të prokurimeve periodike të Autoritetit Kontraktues për të njëjtin objekt të kontratës, përkatësisht për servisimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve për mbrojtje nga zjarri. Këto shërbime janë të detyrueshme sipas legjislacionit për mbrojtje nga zjarri dhe akteve nënligjore që burojnë nga ai legjislacion.

Megjithatë, mënyra se si është strukturuar ky aktivitet, përfshirë metodologjinë e poentimit dhe trajtimin e shërbimeve të mirëmbajtjes së sistemeve me aerosol, është e paqartë dhe jotransparente. Sipas vlerësimit tonë, kjo mënyrë e strukturimit e kufizon konkurrencën efektive, nuk garanton trajtim të barabartë dhe proporcional të operatorëve ekonomikë dhe nuk siguron menaxhim efikas të parasë publike, siç kërkohet nga LPP.

Për këtë arsye, me qëllim të sqarimit të këtyre paqartësive, më **16.04.2026** kemi parashtruar kërkesë për informata shtesë. Më **20.04.2026**, Autoriteti Kontraktues është përgjigjur pjesërisht ndaj kërkesës sonë për informata shtesë, si dhe ndaj kërkesave të disa operatorëve të tjerë ekonomikë.

Megjithatë, duke qenë se Autoriteti Kontraktues nuk i ka trajtuar në mënyrë të plotë dhe substanciale kërkesat tona për informata shtesë, ashtu siç kërkohet me LPP, më datën **28.04.2026** kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim.

Autoriteti Kontraktues nuk i ka trajtuar në mënyrë të mirëfilltë as pretendimet tona ankimore të paraqitura përmes kërkesës për rishqyrtim. Përkundrazi, i ka refuzuar ato në mënyrë të përgjithshme, pa ndërmarrë

veprime korrigjuese për ta sjellë Dosjen e Tenderit në përputhje me LPP-në dhe duke qëndruar prapa veprimeve të tij fillestare.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur mënyra e poentimit në aktivitetet e viteve **2020, 2023** dhe **2026**, ndërsa për vitin **2026** është paraqitur edhe buxheti i planifikuar për secilën kategori:

Kategoria / Viti	2020 [80.000 EUR]	2023 [50.000 EUR]	2026 [70.000 EUR]*
I – Furnizimi me gjeneratorë aerosoli	50%	50%	30% / 21.000 EUR
II – Furnizimi me aparate për fikjen e zjarrit	40%	40%	10% / 7.000 EUR
III – Servisimi dhe mirëmbajtja	10%	10%	60% / 42.000 EUR

* Poentimi dhe buxheti i planifikuar për secilën kategori.

Nga analiza krahasuese e mënyrës së paraqitjes dhe trajtimit të produkteve të prodhuesit **FirePro** në faza të ndryshme të prokurimit, rezulton një mospërputhje e theksuar dhe juridikisht relevante.

Në fazën kur objekt i prokurimit është **furnizimi dhe instalimi** i këtyre produkteve, ato paraqiten si zgjidhje ekonomike, me strukturë të thjeshtuar teknike dhe me kërkesa minimale për mirëmbajtje gjatë ciklit të tyre jetësor, ashtu siç thekson edhe vetë prodhuesi i këtyre produkteve **“do not require a complex network of pipes, and have low maintenance requirements over their 15-year lifetime”**, pra se nuk kërkojnë rrjet kompleks tubacionesh dhe kanë nevoja të ulëta për mirëmbajtje gjatë jetëgjatësisë 15-vjeçare.

Në kundërshtim me këtë përshkrim, në fazën kur objekt i prokurimit është **servisimi dhe mirëmbajtja** e këtyre sistemeve, AK në dosje të tenderit parasheh edhe furnizimin e një sistemi të plotë me gjeneratorë aerosoli, përkatësisht trajtimin e tij si rezervë e plotë, me arsyetimin e mundësisë së paraqitjes së rrethanave të paparashikuara, të jetëgjatësisë së pajisjeve, të mungesës së të dhënave për vjetërsinë e tyre, si dhe të mundësisë së zëvendësimit të pajisjeve më të vjetra se 15 vjet me pajisje të reja.

Një qasje e tillë është teknikisht, ekonomikisht dhe juridikisht e pajustificuar. Në terma praktikë, kjo do të ishte e barsvlershme me një aktivitet prokurimi për **servisimin e automjeteve**, ku, përveç shërbimit të servisimit, Autoriteti Kontraktues do të kërkonte edhe ofertim për **një automjet të plotë si pjesë rezervë**, me arsyetimin se në ndonjë situatë të paparashikuar ose aksident mund të paraqitet nevoja për zëvendësim të plotë të pjesëve. Një logjikë e tillë e tejkalon qartazi natyrën dhe qëllimin e kontratës për mirëmbajtje.

Si rrjedhojë, krijohet një mospërputhje substanciale ndërmjet mënyrës se si këto produkte paraqiten në fazën e furnizimit dhe mënyrës se si trajtohen në fazën e mirëmbajtjes. Në njërën anë, ato paraqiten si sisteme me kërkesa të ulëta mirëmbajtjeje; në anën tjetër, në kuadër të kontratës së servisimit trajtohen si sisteme që mund të kërkojnë ndërhyrje të gjera, deri te zëvendësimi i komponenteve esenciale apo të vetë sistemit.

Po ashtu, ekziston edhe një disproporcion i dukshëm ekonomik: ndërsa në fazën e furnizimit çmimet e këtyre produkteve paraqiten shumë të larta, në fazën e mirëmbajtjes çmimet e pajisjeve paraqiten dukshëm më të ulëta. Kjo rrethanë krijon bazë të arsyeshme për të dyshuar se struktura e kërkesave teknike dhe ekonomike nuk është ndërtuar mbi nevoja reale dhe objektive të kontratës, por në mënyrë që mund të deformojë ofertimin, krahasueshmërinë e ofertave dhe konkurrencën efektive. Këto pretendime do të mbështeten me prova konkrete gjatë shqyrtimit ankimor.

Është me rëndësi të theksohet se Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, përkatësisht në Tabelën 1, secilin pozicion e ka formuluar me shprehjen **“Furnizimi dhe instalimi i...”**, duke krijuar përshtypjen e qartë se bëhet fjalë për **instalim të ri të pajisjeve dhe sistemeve**.

Po ashtu, përshkrimi i **pozicionit 20**, ku parashihet **“Aktivizimi I sistemit ekzistues të një dhome I cili është I fikur ose është jasht funksionimit duke servisuar-riparuar panelin komandues apo pajisjet tjera ekzistuese - vetëm puna”**, bashkë me sqarimin shtesë sipas të cilit **“Të gjitha pozicionet përfshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin si dhe vurjen në vepër të materialeve për secilin pozicion si dhe të gjitha punët dhe materialet e nevojshme përcjellëse që aktivitetet të jetë funksionale (, masat mbrojtëse për siguri**

në punë etj.)”, është formuluar në mënyrë që krijon përshtypjen se bëhet fjalë për instalim ose riaktivizim substancial të sistemeve, pa e kufizuar qartë fushën e punëve “sipas nevojës”.

Gjithashtu, në **Aneksin 1**, Autoriteti Kontraktues ka përfshirë formulimin “**Aparatet me gaz të cilat duhet të kontrollohen në çdo 3 muaj dhe të mbushen në çdo 6 muaj dhe të furnizohen këto aparate për pika të caktuara në objektet ku ka nevojë sipas normave ligjore si dhe servisimi i hidrantëve të cilat janë të vendosura në objekt të SKGJK-se dhe gjykatave të cilat mundësojnë spërkatjen me ujë në raste të paraqitjes së zjarrit.”** Ky formulim përmban të dhëna të paqarta dhe të pasakta, të cilat nuk gjejnë mbështetje të qartë në **Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri** apo në aktet nënligjore përkatëse.

Nga mënyra e ndërtimit të këtyre kërkesave krijohet përshtypja e bazuar se përshkrimet teknike janë hartuar në mënyrë të zgjeruar dhe të ekzagjeruar, me qëllim të krijimit të një baze artificiale për arsyetimin e buxhetit të paraparë prej **70,000.00 EUR**, e jo për të pasqyruar nevojat reale, të sakta dhe proporcionale të kontratës. Për pasojë, këto kërkesa cenojnë qartësinë e objektit të prokurimit, dëmtojnë transparencën, vështirësojnë konkurrencën efektive dhe hapin rrugë për ofertim jo real dhe për trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Për pasojë, ekziston dyshim i bazuar se kërkesat e paraqitura në dosjes të tenderit nuk janë të arsyetuara në aspektin teknik dhe ekonomik, nuk janë proporcionale me objektin e kontratës dhe nuk janë të lidhura realisht me nevojat e shërbimit të kërkuar.

Në vijim do të trajtohen në mënyrë të veçantë elementet konkrete të Dosjes së Tenderit dhe ndikimi i tyre në ligjshmërinë e procedurës së prokurimit dhe në konkurrencën efektive në treg.

PRETENDIMI ANKIMOR 1

Mosshqyrtimi i plotë dhe substancial i kërkesës për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues

Më 16.04.2026 kemi parashtruar kërkesë për informata shtesë, me qëllim të sqarimit të paqartësive në Dosjen e Tenderit dhe korrigjimit të kërkesave, të cilat sipas vlerësimit tonë, cenojnë transparencën, konkurrencën efektive dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Në kërkesën tonë janë përfshirë çështje thelbësore për përgatitjen e ofertës, përfshirë afatin për kërkimin e sqarimeve, metodologjinë e përcaktimit të çmimit të peshuar për njësi, mungesën e sasive indikative, specifikimet teknike për sistemet aerosol, si dhe paqartësitë në pozicione të caktuara të listës së çmimeve.

Prova 01: Kërkesa për informata shtesë, datë 16.04.2026

Dokumenti: 04_KGJK_Kerkesa_per_informata_shtese_16.04.2026.pdf

Më 20.04.2026, Autoriteti Kontraktues ka dhënë përgjigje vetëm pjesërisht ndaj kërkesës sonë për informata shtesë. Përgjigjet e dhëna nuk i kanë trajtuar në mënyrë të plotë, konkrete dhe substanciale çështjet e ngritura, si dhe nuk kanë eliminuar paqartësitë kryesore të dokumentacionit të tenderit.

Prova 02: Sqarime e Autoritetit Kontraktues ndaj kërkesës tonë për informata shtesë, më 20.04.2026

Dokumenti: 07_Sqarimi_01 20.04.2026.pdf

Ky veprim bie ndesh me nenin 53 të LPP-së, i cili rregullon sigurimin e informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit. Qëllimi i kësaj dispozite nuk është thjesht dhënia e një përgjigjeje formale, por sigurimi i informatave të nevojshme dhe të mjaftueshme që operatorët ekonomikë të mund të përgatisin oferta të qarta, të krahasueshme dhe në kushte të barabarta.

Për shkak se përgjigjet e Autoritetit Kontraktues nuk i kanë zgjidhur paqartësitë dhe nuk i kanë trajtuar në mënyrë substanciale kërkesat tona, më 28.04.2026 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim, në pajtim me nenin 108/A të LPP-së.

Prova 03: Kërkesa për Rishqyrtim, më 28.04.2026

Dokumenti: 11_KGJK_Kerkese_per_rishqyrtim_28.04.2026.pdf

Megjithatë, edhe me rastin e shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, AK nuk i ka trajtuar pretendimet tona në mënyrë individuale, të argumentuar dhe substanciale. Më saktësisht, AK nuk ka dhënë arsyetim konkret për secilin pretendim dhe pse i refuzon ato, por është mjaftuar me një përgjigje të përgjithshme refuzuese, duke qëndruar pas veprimeve fillestare dhe duke mos ndërmarrë asnjë veprim korrigjues.

Një vendim i tillë është në kundërshtim me nenin 62.2 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, sipas të cilit vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim duhet të jetë i arsyetuar. Arsyetimi nuk mund të jetë formal apo i përgjithshëm, por duhet të tregojë qartë për secilin pretendim, arsyet pse pretendimet e operatorit ekonomik konsiderohen të pabazuara.

Mosshqyrtimi substancial i Kërkesës për Rishqyrtim cenon efektivitetin e mjetit juridik paraprak të paraparë me nenin 108/A të LPP-së, duke na detyruar të paraqesim ankesë në OSHP, në pajtim me nenin 109 të LPP-së dhe nenin 64.1 të Rregullores Nr. 001/2022.

Prova 04: Vendimi i AK ndaj kërkesës për rishqyrtim, më 29.04.2026

Dokumenti: 12_Vendimi_ne_kerkesen_per_rishqyrtim_29.04.2026.pdf

PRETENDIMI ANKIMOR 2

Përdorimi i çmimit për njësi me peshim/poentim është i pajustificuar, pasi sasi të janë të njohura ose së paku të përcaktueshme

Në Kërkesën për Rishqyrtim kemi sqaruar se përdorimi i kriterit **“çmimi më i ulët për njësi me peshim/poentim”** nuk është i justifikuar në rrethanat konkrete të këtij aktiviteti të prokurimit. Të njëjtin pretendim po e paraqesim edhe në këtë ankesë, duke e plotësuar me shembuj konkretë që dëshmojnë rrezikun praktik dhe pasojat abuzive që mund të krijohen nga kjo metodologji.

Sipas nenit 17.33 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues duhet t'i specifikojë sasi të gjatë përgatitjes së materialeve tenderuese, përfshirë publikimet, dosjen e tenderit dhe kontratën. Ndërsa, sipas nenit 17.34 të së njëjtës Rregullore, në rastin e kontratave kornizë ku sasi të nuk mund të parashikohen në mënyrë të saktë, AK duhet të përfshijë së paku një parashikim të përafërt të sasive, i cili mund të bazohet në konsumin e mëhershëm dhe në nevojat e njohura të autoritetit.

Vetëm në rastin e përcaktuar me nenin 17.35 të Rregullores Nr. 001/2022, kur Autoriteti Kontraktues nuk i di sasi të indikative, mund të përdoret metoda e çmimit për njësi me peshim/poentim.

Prandaj, përdorimi i kësaj metode **nuk përbën kompetencë të pakufizuar diskrecionale të AK.**

AK nuk mund të aplikojë çmimin për njësi me peshim/poentim vetëm duke vendosur përqindje për kategori, pa arsyetuar paraprakisht pse sasi të nuk mund të përcaktohen ose të parashikohen së paku në mënyrë të përafërt.

Në rastin konkret, objekti i kontratës ka të bëjë me servisimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve ekzistuese për mbrojtje nga zjarri, si dhe me furnizime të ndërlydhura me këto pajisje. Për këtë lloj shërbimi, sasi të janë të njohura ose, së paku, të përcaktueshme nga evidencat ekzistuese të AK-së, historiku i mirëmbajtjes, numri i pajisjeve, lloji i tyre, lokacionet ku janë të instaluar dhe periodiciteti i servisimit.

Kjo është theksuar edhe në kërkesën tonë për informata shtesë, ku kemi sqaruar se sasi të në këtë aktivitet nuk janë të panjohura, por të përcaktueshme mbi bazën e periodicitetit ligjor dhe teknik të kontrollit, evidencave ekzistuese të pajisjeve dhe historikut të mirëmbajtjes.

Në këtë drejtim, Ligji Nr. 08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri dhe aktet përkatëse nënligjore parashohin mirëmbajtje dhe kontroll periodik të pajisjeve për mbrojtje nga zjarri. Në nenin 15, “Mirëmbajtja e pajisjeve dhe mjeteve”, parashihet se këto pajisje duhet të mirëmbahen, ndërsa në nenin 16, “Dëshmia për gjendjen e

rregullt të pajisjeve”, përcaktohet se kontrolli duhet të kryhet nga persona të licencuar, në përputhje me normativat teknike dhe udhëzimet e prodhuesit.

Në veçanti, sipas provave të bashkëngjitura:

- pajisjet statike të destinuara për lajmërimin dhe fikjen e zjarrit (këtu bëjnë pjesë edhe gjeneratorët e aerosolit) kontrollohen së paku **një herë në vit nga kompani e licencuar**, ndërsa kontrolli vizual kryhet së paku **një herë në muaj nga përdoruesi** i pajisjeve;
- aparatet bartëse dhe lëvizëse për shuarjen e zjarrit kontrollohen **çdo gjashtë muaj nga kompani e licencuar**, ndërsa **kontrolli vizual kryhet së paku një herë në muaj nga përdoruesi** i pajisjeve;
- hidrantët testohen së paku një herë në vit nga kompani e licencuar, ndërsa kontrolli vizual kryhet së paku një herë në muaj nga përdoruesi i pajisjeve.

Për çdo kontroll mbahet procesverbal, ku evidentohen data e kontrollit, personi përgjegjës dhe gjendja e konstatuar e pajisjes. Kjo nënkupton se Autoriteti Kontraktues disponon ose do të duhej të dispononte të dhëna të sakta për pajisjet ekzistuese që janë objekt i këtij aktiviteti.

Prova 05: [LIGJI NR. 08/L-261 PER MBROJTJE NGA ZJARRI](#)

Prova 06: [UA NR. 17 2017- PËR TESTIMIN DHE SERVISIMIN E APARATEVE PËR FIKJE TËZJARRIT](#)

Prova 07: [UA NR. 24 2012- PER RRJETIN E HIDRANTEVE PER FIKJEN E ZJARRIT](#)

(për të hapur linqet e mësipërme shtyp tastin Ctrl + kliko mbi titull)

Në vijim, si dëshmi po bashkëngjisim raportet e testimin të hidrantëve dhe aparateve për shuarjen e zjarrit, të detyrueshme sipas legjislacionit përkatës, në të cilat regjistrohen të dhëna individuale për secilën pajisje. Këto raporte përbëjnë provë të qartë se gjendja faktike, identifikimi i pajisjeve dhe sasitë përkatëse janë të njohura dhe të verifikueshme me saktësi të plotë.

Prova 07: *Raporti i servisimit të aparateve për shuarjen e zjarrit*

Dokumenti: [14_Raporti_i_servisimit_te_aparateve.pdf](#)

Provë 08: *Raporti i testimin të hidranteve*

Dokumenti: [15_Raporti_i_testimit_te_hidranteve.pdf](#)

Sipas UA Nr. 17/2017 për testimin dhe servisimin e aparateve për fikje të zjarrit, është e mundur që edhe nevojat për furnizim me pajisje të reja të planifikohen me saktësi.

Po ashtu, edhe prodhuesi i gjeneratorëve të aerosolit, FirePro, në dokumentin **“Information, Instruction & User Manual”**, përshkruan në mënyrë të detajuar se kush, kur dhe si duhet të bëjë inspektimin e sistemit me gjeneratorë aerosoli. Ndër të tjera, në këtë manual theksohet se me rastin e çdo inspektimi duhet të përgatitet **“logbook”**, përkatësisht libri i regjistrimit, në të cilin evidentohen të dhëna të detajuara për gjendjen e sistemit.

Në të njëjtin manual thuhet se kontrollet mujore, të cilat janë të thjeshta dhe kryesisht vizuale, kryhen nga vetë përdoruesi i pajisjeve. Po ashtu, manuali sqaron mënyrën e kalkulimit të numrit dhe masës së gjeneratorëve të aerosolit, sidomos në rastet kur duhet të bëhet ndonjë instalim i ri.

Prova 09: [FIREPRO EN MANUAL](#) (kliko linkun)

Nga sa u tha më lart, rrjedh se Autoriteti Kontraktues disponon, ose së paku do të duhej të dispononte, evidencë të saktë për numrin, llojin, gjendjen dhe afatet e skadencës së secilës pajisje ekzistuese. Në këto rrethana, përdorimi i çmimit për njësi me peshim/poentim është i pajustificuar, pasi nuk është dëshmuar se sasitë indikative janë të panjohura apo objektivist të pamundura për t’u parashikuar.

Aplikimi i çmimit për njësi me peshim/poentim, në rastet kur është e mundur të përcaktohen së paku sasitë indikative, krijon mundësi reale për abuzim. Kjo për arsye se operatorët ekonomikë mund t’i ulin artificialisht çmimet në pozicionet që kanë ndikim më të madh në poentim dhe, njëkohësisht, t’i rrisin çmimet në pozicionet që pritet të porositen realisht gjatë ekzekutimit të kontratës.

Kjo situatë bëhet edhe më problematike kur kombinohet me specifitime teknike të përshtatura për një prodhues të caktuar, në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së.

Në rastin konkret, specifikimet teknike janë përshtatur për produktet e prodhuesit FirePro, të cilat, përveç tjerash, janë të patentuara, ndërsa njëkohësisht është përdorur metodologjia e çmimit për njësi me peshim/poentim pa përcaktimin e sasive indikative. Ky kombinim krijon një situatë skajshmërisht abuzive, sepse kufizon konkurrencën efektive, favorizon operatorët që kanë qasje të drejtpërdrejtë në produktet FirePro, e bën të pamundur krahasimin real të çmimeve, lejon deformimin artificial të strukturës së çmimeve dhe nuk garanton që oferta e poentuar si më e lira të jetë realisht oferta më ekonomike gjatë ekzekutimit të kontratës.

Për të dëshmuar këtë rrezik, në vijim paraqesim krahasimin e çmimeve për të njëjtat produkte dhe shërbime FirePro në tri situata konkrete.

Situata 1: Kontrata e KPK-së me GOE AntiFire SH.P.K. & Advanced Group of Architecture SH.P.K.

Në situatën e parë bëhet fjalë për aktivitetin e prokurimit “**Ri-tender: Furnizimi, instalimi i sistemit të sigurisë kundër zjarrit në Arkiva**”, me numër të prokurimit **250-24-11417-1-2-1**. Kontrata është lidhur më **11.04.2025** ndërmjet **Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK)** dhe grupit të operatorëve ekonomikë **AntiFire SH.P.K. & Advanced Group of Architecture SH.P.K.**

Kjo situatë paraqet çmimet kontraktuale të ofruara nga AntiFire SH.P.K., i cili, sipas provave të paraqitura, është përfaqësues zyrtar i prodhuesit FirePro.

Prova 10: Kontrata e lidhur ndërmjet GOE AntiFire SH.P.K. & Advanced Group of Architecture SH.P.K. me KPK, datë 11.04.2025

Dokument: 16_Kontrate_250-24-11417-1-2-1_KPK_Antifire_11.04.2025.pdf

Situata 2: Oferta e GOE AntiFire SH.P.K. & GB në aktivitetin e KGJK-së

Në situatën e dytë bëhet fjalë për ofertën e grupit të operatorëve ekonomikë **AntiFire SH.P.K. & GB SH.P.K.**, të dorëzuar në aktivitetin e prokurimit “**Servisim dhe mirëmbajtja e sistemit të shuarjes automatike të zjarrit (aerosol) dhe aparateve kundër zjarrit në gjykatat e Kosovës dhe në SKGJK**”, me numër të prokurimit **328-23-10366-2-2-1**.

Ky aktivitet është zhvilluar nga **Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)** në vitin 2024.

Është me rëndësi të theksohet se në situatën 1 dhe në situatën 2 bëhet fjalë për të njëjtin operator ekonomik, përkatësisht AntiFire SH.P.K., i cili megjithatë, ka ofertuar me çmime shumë të ndryshme për produkte të njëjta të prodhuesit FirePro.

Prova 11: Oferta e GOE AntiFire SH.P.K. & GB

Dokument: 17_Oferta_e_GOE_AntiFire_SH.P.K._&_GB.pdf

Situata 3: Kontrata e KGJK-së me GOE Professional Alarm SH.P.K. & Proglobal SH.P.K.

Në situatën e tretë bëhet fjalë për të njëjtin aktivitet të prokurimit të përshkruar në situatën e dytë, përkatësisht “**Servisim dhe mirëmbajtja e sistemit të shuarjes automatike të zjarrit (aerosol) dhe aparateve kundër zjarrit në gjykatat e Kosovës dhe në SKGJK**”, me numër të prokurimit **328-23-10366-2-2-1**.

Në këtë rast, kontrata është lidhur më **11.01.2024** me grupin e operatorëve ekonomikë **Professional Alarm SH.P.K. & Proglobal SH.P.K.**

Kjo situatë është e rëndësishme për krahasim, sepse bëhet fjalë për të njëjtin aktivitet të prokurimit si në situatën 2, me të njëjtin objekt kontrate, me të njëjtat specifitime teknike dhe me të njëjtën metodologji të vlerësimit.

Prova 12: Kontrata e lidhur ndërmjet GOE Professional Alarm SH.P.K. & Proglobal SH.P.K. me KGJK, më 11.01.2024

Dokument: 18_Kontrate_328-23-10366-2-2-1_KGJK_Professional_Alarm_11.01.2024.pdf

Krahasimi i çmimeve në tri situatat

Specifikimet teknike, siç u tha më sipër, janë të njëjta dhe të përshtatura për produktet e prodhuesit FirePro. Po ashtu, është përdorur e njëjta renditje dhe e njëjta metodologji e vlerësimit. Prandaj, krahasimi i çmimeve

është i drejtpërdrejtë dhe i qartë.

Poz.	Pershkrimi i produktit / shërbimit	Sasia	Çmimi/njësi KPK (situata 1)	Çmimi/njësi KGJK (situata 2)	Çmimi/njësi KGJK (situata 3)
1.	FirePro Sigma XT Panel	1 cope	769,00 EUR	270,00 EUR	270,00 EUR
2.	FP-SA / GEN 3.0	1 cope	80,00 EUR	5,00 EUR	10,00 EUR
3.	Baza e detektoret	1 cope	10,00 EUR	2,00 EUR	1,00 EUR
4.	Detektor optic konvecional S1000	1 cope	52,00 EUR	14,00 EUR	6,00 EUR
5.	Detektor optic konvecional S3500A1R	1 cope	52,00 EUR	13,50 EUR	6,00 EUR
6.	Butoni për çkyqjen RPBS11CL	1 cope	40,00 EUR	18,00 EUR	12,00 EUR
7.	Sirena me ndricim RoLP & Solex	1 cope	68,00 EUR	45,00 EUR	15,00 EUR
8.	Shenja sinjalizuese FL-24	1 cope	76,00 EUR	52,00 EUR	20,00 EUR
9.	Bateri 12V, 7A	1 cope	40,00 EUR	20,00 EUR	20,00 EUR
10.	Thirres automatic SD1+	1 cope	284,00 EUR	142,00 EUR	35,00 EUR
11.	Zile alarmi MBM246	1 cope	55,00 EUR	26,00 EUR	10,00 EUR
12.	Gjenerator Aerosoli FP-1200TS	1 cope	790,00 EUR	500,00 EUR	250,00 EUR
13.	Gjenerator Aerosoli FP-2000TS	1 cope	980,00 EUR	700,00 EUR	420,00 EUR
14.	Gjenerator Aerosoli FP-3000TS	1 cope	1298,00 EUR	1000,00 EUR	600,00 EUR
15.	Kablo 2x1 mm	1 meter	4,00 EUR	2,00 EUR	2,00 EUR
16.	Llambë simulimi	1 cope	1,00 EUR	1,00 EUR	5,00 EUR
17.	Instalimi dhe material tjetër shpenzues	1 cope	400,00 EUR	75,00 EUR	100,00 EUR
18.	Aktivator TERMIK (BTA)	1 cope	70,00 EUR	60,00 EUR	30,00 EUR
19.	Furnizimi dhe instalimi me Damper	1 cope	550,00 EUR	350,00 EUR	180,00 EUR
20.	Kontrolla rutinore	1 ndertese	600,00 EUR	150,00 EUR	250,00 EUR
21.	Kontrollimi detal... obligativ 1x ne vire	1 ndertese	600,00 EUR	150,00 EUR	400,00 EUR
22.	Aktivizimi i sistemit nese eshte i fikur	1 dhome	600,00 EUR	150,00 EUR	220,00 EUR

Nga ky krahasim shihet qartë se, edhe kur kemi të njëjtin operator ekonomik në situatën 1 dhe situatën 2, përkatësisht **AntiFire SH.P.K.**, çmimet për produkte të njëjta ose të krahasueshme ndryshojnë në mënyrë substanciale.

Për shembull:

- **FP-SA / GEN 3.0** është ofertuar me **80,00 EUR** në situatën 1, ndërsa me **5,00 EUR** në situatën 2;
- **FirePro Sigma XT Panel** është ofertuar me **769,00 EUR** në situatën 1, ndërsa me **270,00 EUR** në situatën 2;
- **Instalimi dhe materiali tjetër shpenzues** është ofertuar me **400,00 EUR** në situatën 1, ndërsa me **75,00 EUR** në situatën 2;
- **Kontrolli rutinor** është ofertuar me **600,00 EUR** në situatën 1, ndërsa me **150,00 EUR** në situatën 2.

Arsyeja e këtij ndryshimi kaq të madh të çmimeve mund të shpjegohet me faktin se, në situatën e parë, sipas Dosjes së Tenderit, AK ka kërkuar autorizim nga prodhuesi, duke i siguruar kështu avantazh të padiskutueshëm përfaqësuesit të FirePro, ndërsa në situatën e dytë një autorizim i tillë nga prodhuesi nuk është kërkuar.

Në anën tjetër, në situatën 3, ku kontrata është lidhur me GOE Professional Alarm SH.P.K. & Proglobal SH.P.K., po ashtu vërehen dallime të mëdha në çmime për të njëjtat produkte/shërbime. Në veçanti, çmimet e furnizimit, në disa raste paraqiten ekstremisht të ulëta dhe joreale, kurse në raste të caktuara ekstremisht të larta.


Kjo tregon se metodologjia e përdorur nuk garanton krahasim real dhe objektiv të ofertave, por lejon lstrukturim të çmimeve që mund të përshtaten në mënyrë artificiale sipas peshëve të vendosura në dosjen e tenderit.

Në kërkesëm për rishqyrtim e kemi paraqitur edhe nje shembull, ku kontrata paraprake ilustron qartë se si mungesa e sasive indikative dhe përdorimi i peshimit mund të prodhojnë çmime të deformuara, të cilat i përmendëm më sipër.

Për shembull, për aparatën për fikjen e zjarrit është ofertuar çmimi prej **23,00 EUR**, ndërsa vetëm për ampullën e çelikut, e cila është një pjesë përbërëse e aparatit (si në figurat më poshtë), është ofertuar çmimi **36,00 EUR**. Pra, një pjesë e veçantë e aparatit është ofertuar më shtrenjtë se vetë pajisja e kompletuar, gjë që paraqet një mospërputhje të qartë ekonomike në strukturën e çmimeve.

Po ashtu, në kontratën paraprake, çmimi për një tiketë udhëzimi për aparat, në vlerë prej **6,50 EUR**, është dukshëm më i lartë se vlera e zakonshme e tregut.

Tabela II – artikuj në poz. 2 dhe 5 e kontratës së kaluar:

A - APARATI ME BOMBOLË (ME AMPULLË TË ÇELIKTË)	B - AMPULLA E ÇELIKTË
	
<p>Çmimi nga tenderi i kaluar, për aparatën me ampullë: 23,00 EUR</p>	<p>Vetëm ampulla: 36,00 EUR</p>

Në rastin konkret, mungesa e një strukture të qartë dhe përdorimi i çmimit për njësi me peshim/poentim, pa arsytim të mjaftueshëm, cenon qëllimin e LPP-së për shfrytëzim efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike. Për këto arsye, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me **nenet 6 dhe 7 të LPP-së**, si dhe me **nenet 17.33, 17.34 dhe 17.35 të Rregullores Nr. 001/2022**, duke aplikuar metodën e çmimit për njësi me peshim/poentim pa dëshmuar se sasi të indikative nuk mund të përcaktohen dhe pa dhënë së paku një parashikim të përafërt të tyre.

Në mënyrë që të shmangen paqartësitë, të sigurohet një tender i matshëm dhe të garantohet përputhshmëria me LPP-në, Autoriteti Kontraktues duhet të japë të dhëna të qarta dhe të sakta për secilin pozicion, duke përfshirë shpeshhtësinë e servisimit/mirëmbajtjes dhe sasi të indikative, në rastet kur sasi të sakta nuk dihen.

Këto të dhëna duhet të paraqiten në mënyrë të strukturuar, sipas shembullit në vijim:

Tabela 1:

Furnizimi me pjesë rezervë për zëvendësimin e pjesëve apo gjeneratorëve të aerosolit duhet të bëhet duke u bazuar në nevoja reale, duke përfshirë sasi të indikative dhe specifikimet teknike në përputhje me LPP-në.

Tabela 2:

Furnizimi me aparate për shuarjen e zjarrit duhet të bëhet duke u bazuar në nevoja reale, duke përfshirë sasi të indikative dhe specifikimet teknike në përputhje me LPP-në.

Tabela 3:

Në tabelën e servisimit duhet të jepen sasi të indikative dhe shpeshhtësia e servisimit, sipas shembullit të mëposhtëm.

Nr.	Përshkrimi i artikullit/shërbimit	Njësia	A - Sasia (indikative)	B - Numri i shërbimeve	C - Çmimi për njësi	Totali
1	Servisimi i aparateve kundër zjarrit	copë	X	4	...	A x B x C
2	Kontrolli/servisimi i gjeneratorëve aerosol	dhomë/sistem	x	2	...	A x B x C
3	Kontrollimi i hidrantëve	copë	X	2	...	A x B x C

Nëse vepohet sipas kësaj skeme, fatura finale për AK-në do të jetë shumë herë më e ulët se deri më tani, ndërsa mundësia e abuzimit me paranë publike do të minimizohet dukshëm.

PRETENDIMI ANKIMOR 3

Kundërshtim ndaj përgjigjes së Autoritetit Kontraktues për kërkesat nr. 3 dhe nr. 4

Përgjigjja e Autoritetit Kontraktues ndaj kërkesave tona nr. 3 dhe nr. 4 është e paplotë dhe nuk e adreson përmbajtjen reale të kërkesave për sqarim dhe korrigjim. Në vend që të japë sqarime teknike, të qarta dhe të plota për secilin pozicion të kontestuar, AK është kufizuar në përgjigje të përgjithshme, duke deklaruar se është përdorur shprehja **“ose ekuivalent”**, se kontratat e përziera janë të lejuara me LPP dhe se disa kërkesa **“duhet të jenë të nënkuptueshme”**.

Ky qëndrim nuk është në përputhje me detyrimin e AK-së për dhënien e përgjigjeve të qarta dhe të plota. Sipas nenit 45.13 të Rregullores Nr. 001/2022, Autoriteti Kontraktues duhet të sigurohet që përgjigjet në kërkesat për sqarim të jenë të qarta dhe të ofrojnë të gjithë informacionin e kërkuar.

Në rastin konkret, AK nuk ka dhënë përgjigje të plotë lidhur me kërkesat tona për heqjen ose ndarjen e pozicioneve që lidhen me sistemin me aerosol, saktësimin e specifikimeve teknike dhe standardeve, si dhe përputhshmërinë teknike të pjesëve të kërkuara.

Sa i përket sistemit me aerosol FirePro, vetëm përdorimi i shprehjes **“ose ekuivalent”** nuk e bën automatikisht të ligjshëm specifikimin. Sipas nenit 28 të LPP-së, AK nuk duhet të përpilojë specifikime teknike që i referohen një artikulli, burimi, procesi, shenje dalluese, lloji, origjine apo prodhimi të veçantë. Një referim i tillë lejohet vetëm në kushte të jashtëzakonshme, kur AK vërteton qartë se nuk është e mundur të përpilohet një specifikim mjaft i saktë dhe i kuptueshëm i lëndës së kontratës, dhe vetëm atëherë referimi duhet të shoqërohet me fjalët **“ose ekuivalent”**.

Prandaj, AK nuk mund të mjaftohet vetëm me shtimin e shprehjes **“ose ekuivalent”**. AK duhet të përcaktojë qartë parametrat teknikë, funksionalë dhe minimalë mbi bazën e të cilëve do të vlerësohet ekuivalenca, në përputhje me nenin 28 të LPP-së.

Po ashtu, nuk kontestojmë në parim se kontratat e përziera mund të jenë të lejuara me LPP. Megjithatë, përgjigjja e AK-së se **“kontratat e përziera janë të lejuara”** nuk e adreson problemin konkret. Çështja kryesore nuk është nëse kontratat e përziera lejohen në parim, por nëse në këtë aktivitet konkret përfshirja e pozicioneve të ndryshme, pa ndarje dhe arsytim të qartë, siguron konkurrencë efektive, krahasim objektiv të ofertave dhe përputhje me LPP-në.

Për pozicionin **“Aparati P6 (6 kg) – Pluhur ABC”**, AK është përgjigjur se produkti duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve të parapara me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri dhe se kjo **“duhet të jetë e nënkuptueshme”**. Ky arsytim nuk është i mjaftueshëm. Kërkesat teknike nuk mund të mbeten të nënkuptuara, por duhet të jenë të përcaktuara qartë në Dosjen e Tenderit.

Derisa për gjeneratorët e aerosolit është dhënë një specifikim i detajuar, për aparatet për shuarjen e zjarrit nuk është përcaktuar asnjë specifikim teknik i qartë dhe as standard konkret. Një qasje e tillë krijon paqartësi për operatorët ekonomikë dhe pamundëson përgatitjen e ofertave të krahasueshme.

Për pozicionin **“Ampulla të çeliktë”**, AK është përgjigjur vetëm se ato kërkohen për aparate të madhësisë 6 kg.

Kjo përgjigje nuk e adreson plotësisht kërkesën tonë, sepse nuk sqaron të dhënat teknike të nevojshme për ofertim, përfshirë përputhshmërinë me aparatet ekzistuese, gjendjen teknike të tyre, vitin e prodhimit dhe nevojën reale për këtë pjesë.

Është e paqartë pse “ampullat e çelikta” janë përfshirë në Listën e Çmimeve, kur bëhet fjalë për pjesë që zakonisht përdoren në aparate të vjetra (më të vjetra se 20 vjetë, të cilat duhet të hiqen nga përdorimi). Kompania jonë, e cila brenda një viti servison deri në **15.000** aparate për shuarjen e zjarrit, nuk ka hasur kërkesë për ndërrim apo mbushje të kësaj pjese për më shumë se 4–5 vite, te asnjë subjekt tjetër, përveç KGJK.

Në mënyrë që të shmangen paqartësitë, të sigurohet një tender i matshëm dhe të garantohet përputhshmëria me LPP-në, AK duhet të japë të dhëna të sakta për secilin pozicion, duke përfshirë specifikimet teknike, standardet e aplikueshme dhe përputhshmërinë me pajisjet ekzistuese.

Për rrjedhojë, përgjigjet e AK-së ndaj kërkesave nr. 3 dhe nr. 4 nuk i eliminojnë paqartësitë e Dosjes së Tenderit. Përkundrazi, ato tregojnë se disa pozicione janë të pasakta, të paplota ose të paqarta dhe kërkojnë korigjim formal.

Mosdhënia e përgjigjeve të plota dhe të qarta është në kundërshtim me nenin 45.13 të Rregullores Nr. 001/2022, si dhe me parimet e nenit 6 dhe nenit 7 të LPP-së për ekonomikitet, transparencë, trajtim të barabartë dhe konkurrencë efektive.

Prandaj, kërkojmë që ky pretendim ankimor të aprovet si i bazuar dhe Autoriteti Kontraktues të obligohet që të korigjojë Dosjen e Tenderit, duke përcaktuar qartë specifikimet teknike, standardet e aplikueshme, parametrat e ekuivalencës dhe përputhshmërinë teknike të pjesëve të kërkuara.

PRETENDIMI ANKIMOR 4

Kundërshtim ndaj përgjigjes së AK-së për kërkesën nr. 5 – “Kontrolla rutinore”

Përgjigjja e Autoritetit Kontraktues lidhur me pozicionin “**Kontrolla rutinore për një objekt/gjykatë**” nuk e eliminon paqartësinë e ngritur. AK ka sqaruar vetëm se kontrolla do të kryhet “**në bazë të kërkesës nga gjykata/administratori**”, mirëpo nuk ka përcaktuar shpeshësinë e kontrollës, e cila është element thelbësor për ta bërë këtë pozicion të matshëm, të ofertueshëm dhe të krahasueshëm.

Nëse një shërbim kërkohet si **kontrollë rutinore**, atëherë ai duhet të ketë periodicitet të qartë, për shembull mujor, tremujor, gjashtëmujor, vjetor ose ndonjë frekuencë tjetër të përcaktuar nga AK. Pa këtë përcaktim, operatorët ekonomikë nuk mund ta kalkulojnë çmimin në mënyrë të saktë, sepse nuk dihet sa herë gjatë periudhës 24-mujore mund të kërkohet ky shërbim.

Për më tepër, ky pozicion nuk mund të lihet në diskrecion të plotë të AK-së, gjykatës ose administratës së gjykatës gjatë ekzekutimit të kontratës, sidomos duke marrë parasysh se një kontrollë e tillë nuk është paraparë as me standarde teknike dhe as me udhëzime të prodhuesit. Sipas legjislacionit përkatës, kontrolla rutinore/vizuale duhet të kryhet nga vetë shfrytëzuesi i pajisjeve.

Përgjigjja se kontrolla kryhet vetëm “**sipas kërkesës**” krijon pasiguri për ofertuesit dhe mundësi që gjatë zbatimit të kontratës shërbimi të kërkohet në mënyrë të paparashikueshme, pa kufi të qartë sasior dhe pa bazë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë në fazën e ofertimit.

Sipas nenit 17.33 të Rregullores Nr. 001/2022, AK duhet të specifikojë sasi të qarta të përgatitjes së materialeve tenderuese. Nëse sasi nuk mund të parashikohen në mënyrë të saktë, sipas nenit 17.34 të së njëjtës Rregullore, AK duhet të japë së paku një parashikim të përafërt. Në rastin konkret, për pozicionin “**kontrollë rutinore**”, AK nuk ka përcaktuar as frekuencën, as numrin e përafërt të kontroleve dhe as ndonjë kufizim sasior për periudhën e kontratës.

Prandaj, ky pozicion mbetet i paqartë, i pamatshëm dhe i pakrahasueshëm, në kundërshtim me parimet e

nenit 6 dhe nenit 7 të LPP-së, si dhe me detyrimet e Rregullores Nr. 001/2022 për specifikimin ose parashikimin e sasive.

Për këtë arsye, kërkojmë që ky pretendim të aprovohet si i bazuar dhe Autoriteti Kontraktues të obligohet që ta korrigjojë Dosjen e Tenderit, duke përcaktuar qartë shpeshtësinë e kontrollës rutinore ose, së paku, numrin indikativ/maksimal të kontrolleve që mund të kërkohen gjatë periudhës së kontratës.

Përfundim

Duke u mbështetur në nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, në aktet nënligjore në fuqi dhe në pretendimet ankimore të paraqitura, Operatori Ekonomik ankues kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:

1. Ta aprovojë ankesën si të bazuar;
2. Ta urdhërojë Autoritetin Kontraktues që, në rast të vazhdimit të këtij aktiviteti të prokurimit, ta rishikojë dhe korrigjojë Dosjen e Tenderit në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, aktet nënligjore përkatëse, si dhe me parimet e konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit;
3. Të konstatojë se veprimet dhe mosveprimet e zyrtarit/zyrtarëve përgjegjës në këtë aktivitet të prokurimit përbëjnë shkelje të rënda të legjislacionit të prokurimit publik, në kuptim të nenit 97.1(d) të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, pasi përfshijnë mosrespektim të parimeve themelore të prokurimit publik dhe vendosje të kërkesave/kritereve jo në përputhje me LPP-në;
4. Të obligojë Autoritetin Kontraktues që të ndërmarrë masa ligjore ndaj zyrtarit/zyrtarëve përgjegjës, si dhe, sipas rastit, të iniciohet procedura për revokimin e certifikatës profesionale të prokurimit, në përputhje me nenet 91 dhe 97 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasojë e drejtpërdrejtë e veprimeve dhe mosveprimeve të kundërligjshme të Autoritetit Kontraktues, Operatori Ekonomik ankues ka pësuar dëme materiale, të manifestuara përmes shpenzimeve të bëra për përgatitjen e ofertës dhe të dokumentacionit ankimor, si dhe përmes humbjes së mundësisë për pjesëmarrje në një konkurrim të drejtë dhe efektiv në këtë procedurë të prokurimit. Këto dëme burojnë drejtpërdrejt nga shkeljet e Ligjit për Prokurimin Publik dhe të akteve nënligjore në fuqi.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

01_B05_Njoftim_per_kontratë_02.04.2026.pdf
02_Dosja_e_tenderit_02.04.2026.Docx
03_Lista_e_cmimeve_02.04.2026.xlsx
04_KGJK_Kerkesa_per_informata_shtese_16.04.2026.pdf
05_Dosja_e_tenderit_versioni_i_pare_i_korrigjuar_17.04.2026.Docx
06_Formulari_standard_per_korrigjimin_e_gabimeve_B54_17.04.2026.Pdf
07_Sqarimi_01_20.04.2026.pdf
07_Sqarimi_02_20.04.2026.pdf.pdf
08_Formulari_standard_per_korrigjimin_e_gabimeve_B54_21.04.2026.Pdf
09_Dosja_e_tenderit_21.04.2026.Docx
10_Lista_e_cmimeve_21.04.2026.xlsx
11_KGJK_Kerkese_per_rishqyrtim_28.04.2026.pdf
12_Vendimi_ne_kerkesen_per_rishqyrtim_29.04.2026.pdf
13_Vendim_per_pezullim_29.04.2026.pdf
14_Raporti_i_servisimit_te_aparateve.pdf
15_Raporti_i_testimit_te_hidranteve.pdf
16_Kontrate_250-24-11417-1-2-1_KPK_Antifire_11.04.2025.pdf
17_Oferta_e_GOE_AntiFire_SH.P.K._&_GB.pdf
18_Kontrate_328-23-10366-2-2-1_KGJK_Professional_Alarm_11.01.2024.pdf